

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 9 DHJETOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi sërish për një argument, i cili ka të bëjë përsëri me pandeminë, por besoj se jemi në një moment akoma më të komplikuar, sepse bëhet fjalë për një kredi të re. Për të mos shkuar më tutje, për disa konsiderata të tjera, për mënyrën sesi këto situata administrohen, për korrektesë edhe të opinionit publik, por edhe të votuesve që do të votojnë në sallë, po e rimarr atë që kam thënë në Komisionin e Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale. Kredi do të thotë të marrësh një borxh dhe të marrësh një borxh është një vendim shumë i vështirë, shumë i rëndë dhe me përgjegjësi të mëdha për financat e vendit, për të sotmen dhe për të ardhmen, sepse është borxh dhe rëndon në kurriz të financave publike dhe të qytetarëve. Qeveria nuk ka një thes të saj, por ka taksat, të cilat qytetarët i paguajnë dhe me të cilat paguajmë këto borxhe të njëpasnjëshme. Siç e keni parë, kjo sallë është shndërruar në një sallë marrëse borxhesh dhe çdo ditë kemi dëgjuar duartrokitje të mëdha sesi kemi qeverinë borxhmarrëse më të mirë që ka ekzistuar në të gjitha kohërat, por le t'i referohemi këtij borxhit përkatës. Këtu, në mënyrë spekulative, paraqitet që këto 60 milionë euro do të mbështesin administrimin dhe problemet e pandemisë. Por çfarë ka vetë kjo marrëveshje?! U bëj thirrje deputetëve të maxhorancës të mos e votojnë, por ta shikojnë me qetësi, t'i japin kohën e duhur, sepse, siç e dini, edhe kjo marrëveshje ka ardhur me procedurë të përshpejtuar. Ngut i madh, që të mos ketë verifikime! Po çfarë thotë marrëveshja, shtojca 6/6? Kush ka seriozitetin t'i shikojë marrëveshjet përpara se t'i votojë, e bën, nuk them për ata që kanë vendosur të mbyllin sytë, të votojnë e të bëjnë detyrën e partisë, le ta bëjnë. Po çfarë thotë shtojca 6/6, që e ka sjellë vetë qeveria? Thotë që është një mbështetje, e cila paska të bëka me financime të periudhës prill-dhjetor të vitit 2020, financime të vitit 2021 dhe financime të vitit 2022.

Çdo qytetar që po e dëgjon këtë seancë pyet, si për çdo borxh, se borxhi nuk merret për t'i mbajtur paratë në arkën e kursimit, por merret se qeveria ka detyrimin e madh të likuidojë disa gjëra: çfarë do të likuidojë ky borxh? Këtu thuhet: "Teknologji mjekësore, vende shtesë, fuqie punëtore, financime të tjera, mjete mbrojtëse e të tjera". Gjëja e parë që do të pyesë çdo shqiptar nga shtëpia për ata që kanë vendosur ta votojnë: sa do të shpenzojnë për secilin artikull, se po marrin borxh? Flas gjithmonë, nëse ka përgjegjshmëri, në qoftë se nuk ka paturpësi në marrjen e parave borxh me miliona, të kthyera në lekë janë miliardë, do të tregohet përse do të përdoren. Nuk e di asnjë, nuk janë të zotët ta thonë as këta. Nuk e thonë dot se për çfarë do t'i shpenzojnë 60 milionë euro. E kam bërë pyetjen. Kam kërkuar sqarim, por nuk ekziston as në letrat formale që kemi këtu nuk ekziston. Po s'i mund të votohet një marrëveshje e tillë, marrëveshje në tym? Secili duhet të skuqet kur e voton. Një marrëveshje zero, pa asnjë sqarim. Ç'do likuidojmë? I morëm borxh me vrap, se kemi disa gjëra për të paguar. Çfarë do të paguajmë? Fuqi shtesë punëtore. Sa janë, a kanë emra? Po marrim mjete mbrojtëse. Sa milionë, për maska, dezinfektantë e të tjera me radhë? Sepse realiteti është krejtësisht i ndryshëm nga to që duam të bëjmë. Janë marrë miliona. Çfarë prodhuan milionat? Që u jepej njerëzve të shërbimit shëndetësor një maskë një herë në 10 ditë, kur sipas OBSH-së, meqenëse i referohen, do të duhet të ndërrohet mbas çdo vizite! Megjithëse për profesion dhe për zanat, këtë vend e ka marrë lumi. Tani, meqenëse

po marrim borxh pas borxhi, duhen bërë edhe disa vlerësime të tjera. Unë mbaj gjithmonë distancë të prerë nga çdo vlerësim, i cili nuk ka të bëjë me profesionin, apo që ka pacipësinë të tallet me shifrat. Do t'u referohem përsëri shifrave zyrtare, megjithëse këtu u shqyen duke folur për sakrificat e mëdha që ka bërë shteti në përballimin e pandemisë. Cilat janë sakrificat që ka bërë shteti? Nga 200 mijë raste të deklaruara, ndonëse e dinë të gjithë, edhe sipas deklarimeve të veta zyrtare, që numri i personave që janë infektuar dhe kanë kaluar COVID-in është shumë herë më i madh se kaq, minimumi 1 milionë e 700 mijë apo e 800 mijë, dhe le ta marrë përsipër ndonjëri ta mohojë këtë shifër po të dojë, por megjithatë e lëmë këtë fakt, le të rrimë te shifra 200 mijë, në 200 mijë njerëz të regjistruar, nga këta rreth 8 000 njerëzve u është rimbursuar një shumë qesharake parash. Pra, 320, 330 ose 350 mijë dollarë kanë dalë këtej. Elementi i parë. Sa është realiteti? Realitetin le ta shikojnë tek të dhënat e spitaleve private, le të interesohen edhe për mijëra të tjerë që kanë shkuar dhe janë kuruar jashtë Shqipërisë. Këto janë faktet reale dhe po t'i vësh në balancë shifrat, merr vesh se ç'ndodh. Duhet të skuqeshin të gjithë ata që flasin për sakrificat e mëdha që bën qeveria, se këta janë numrat, kush flet jashtë numrave është një demagog i pështirë. Do të thotë se rreth 200 milionë euro dalin nga xhepat e shqiptarëve, ndërsa këtej kanë dalë 350 mijë dollarë. Këta që u shqyen për pandeminë, kur u kërkua në këtë sallë dhe u propozua një amendament për të shtuar 2 miliardë lekët të rinj për rimbursimin e barnave, e votuan në bllok kundër, ndërsa tani marrin 60 milionë euro borxh. I kupton dot njeri këta se çfarë flasin?

Nga njëra anë, nuk e miratojnë amendamentin, në anën tjetër, marrin 60 milionë euro borxh. Po për çfarë i marrin? Për të shpërdoruar, se po të ishin të përgjegjshëm, do ta miratonin amendamentin tonë. E dyta: a duan t'i njohin të vërtetat? U tha këtu që gjurmimi vazhdon të mbetet një strategji e përzgjedhur. Sa i takon gjurmimit dhe testimin, këta mund të bëjnë sikur harrojnë, unë nuk harroj, unë kam dëgjuar Kryeministrin (këta mund të thonë çfarë të duan, edhe fjalët që ka thënë ai mund t'i bëjnë hasha, por është turpi i tyre, nuk është imi) që ka thënë se ata që flasin për testimet e shumta janë të komisionuar nga kompanitë që prodhojnë teste, që të përdoren sa më shumë teste. Unë mbaj distancë nga këto turpe të Kryeministrit, por këto janë të vërtetat. Ka qenë po kjo qeveri që, kur kërkohet testimi, thoshte: "Nuk ka nevojë të testojmë, se ne kemi një model si Zvicra, që nuk teston", ndërkohë që Organizata Botërore e Shëndetësisë thoshte: testim, testim, testim. Edhe në momentin që jetojmë, momentalisht, me shifrat e tyre, jo të miat, testimet lëvizin nga dita në ditë, nga 1440 në datën 6 dhjetor, në 2800 – 3000 ditët e tjera. Të jeni të bindur që të gjitha shifrat janë shifra që nuk kanë lidhje me realitetin. Ju e kuptoni, kur ka 200 të sëmurë me 1400 teste, me testimin normal 5000 – 6000 njerëz, do të thotë që kemi 700 - 800 të sëmurë në ditë. Po çfarë janë këta 700-800 persona? Këta njerëz kërkojnë ndihmë financiare. Qoftë edhe forma më e lehtë e virusit kërkon mbështetjen financiare, kërkon kurimin mjekësor bazë, qoftë vitaminat, qoftë elementet e tjera plotësues, kërkojnë para, por këto njerëz nuk janë në defterë.

Ecim më tutje, duke i marrë me radhë: sa është numri i shtrimeve në spital? Merrini, shikojini sa prej tyre marrin shërbime në spitalet private në Shqipëri dhe jashtë saj, cili është proporcioni? Pra, këto janë realitete fare të qarta, që flasin vetë dhe të vazhdosh të marrësh akoma borxh nuk është e drejtë! Do të ishte shumë më e ndershme të thoshit që duam 60 milionë euro borxh, sepse kemi 3 objekte të mëdha të karakterit infrastrukturor apo të karakterit teknologjik, që do t'i mbështesim këtë dhe atë gjë. Kurse sot keni ardhur dhe thoni se do të merrni borxh, por nuk i tregoni asnjë shqiptari se për se do të harxhohen paratë. Kjo është A-ja e çdo marrëveshjeje që duhet të vinte në Kuvendin e Shqipërisë, sepse janë para. Sot, kushdo që do ta votojë këtë marrëveshje, do të votojë vullnetarisht një marrëveshje pa shifra, bosh, të bardhë, është një çek, të cilët i thonë qeverisë: grabiteni, shpërdoroni si t'ju dojë qejfi, sepse ne, me vullnet të lirë, ua kemi dhënë këtë leje. Qeveria do të jetë shumë e qetë, se do të thotë: janë ata të papërgjegjshmit e parlamentit, po që na hyjnë në punë, të papërgjegjshmit e dobishëm që na e japin këtë leje dhe na e miratojnë të bardhë. Kjo është vërteta e

kësaj marrëveshjeje fantomë, që u shfaq, e cila projektohet sikur do të mbështesë pandeminë për vitin 2022, por brenda nëpër tabela paska edhe borxhe të vitit 2020 dhe të vitit 2021, por që nuk merr përsipër njeri t'i deklarojë, sipas dokumenteve të shkruara po vetë, që sjellin në parlament. Marrëveshje të tilla, fantazmë, pa shifra, pa numra, ku merren miliona, pa sqaruar se ku do të shkojnë, sigurisht që asnjë nuk mund t'i mbështesë dhe t'i votojë.